



**KONTROLLIMI EKSTERN I NJOHURIVE
TË NXËNËSVE TË KLASËS SË NËNTË**

KATALOGU I PROVIMIT

HISTORI

VITI MËSIMOR 2012/2013

Katalogun e provimit e përgatitën:

1. Radovan Popoviq, Enti për Shkolla
2. Lilana Bajçeta, Gjimnazi- Plevle
3. Vukoman Rabrenoviq, SHF „ Vuk Karaxhiq“ – Podgoricë
4. Tatjana Mijanoviq , SHF „ Savo Pejanoviq“ – Podgoricë
5. Dragoje Gjokiq, Qendra e Provimeve

Recensent: dr. Gjorgje Borozan

Përktheu:

Luigj Berisha

PËRMBAJTJA

1. Hyrje.....	4
2. Rregullat e provimit.....	5
3. Qëllimet e përgjithshme të provimit.....	6
5. Programi i provimit.....	8
6. Shembulli i testit me skemë për vlerësim.....	21
7. Literatura.....	42

1. HYRJE

Provimi ekstern për nxënësit e klasës IX të shkollës fillore (Matura e Vogël) është kontrollim ekstern i standardizuar i të arriturave shkollore të nxënësve në fund të ciklit të tretë të arsimimit fillor. Një vendim i këtillë ka gjetur mbështetje në Ligjin për shkollën fillore, neni 56 ("Gazeta Zyrtare e RMZ", nr. 64/02 e 8. 11. 2002, 49/07 e 10. 08. 2007 dhe 45/10 e 04. 08. 2010), kurse mënyra dhe procedura e kontrollimit të dijes është e rregulluar me Rregulloren për mënyrën dhe procedurën e kontrollimit të njohurive të nxënësve në fund të ciklit arsimor ("Gazeta Zyrtare e RMZ", nr. 62 e 14. 12. 2012).

Kontrollohen njohuritë, aftësitë dhe shkathtësitë të cilat bazohen në pjesët kryesore të programit të lëndës së historisë, kurse duhet t'i kenë nxënësit në fund të shkollës fillore.

Përgatitjen e detyrave e bën Qendra e Provimeve, derisa kontrollimin e dijes e bën Qendra e Provimeve në bashkëpunim me shkollën. Mënyrën dhe procedurën e kontrollimit të dijes së nxënësve e përcakton Ministria e Arsimit dhe Sportit.

Në provimin ekstern të nxënësve të klasës së nëntë, historia është lëndë të cilën e zgjedh nxënësi nga lista e lëndëve të detyruara.

Katalogu i provimit hollësisht e përshkruan provimin nga Historia dhe u kushtohet nxënësve dhe mësuesve.

Në Katalogun e provimit janë cekur qëllimet e përgjithshme të provimit, është përshkruar struktura e provimit, kurse përmes formës së qëllimeve të provimit saktësisht është thënë përmbajtja e lëndës që i nënshtrohet provimit. Është dhënë edhe shembulli i testit me skemën e hollësishme për vlerësim.

2. RREGULLAT E PROVIMIT

Të gjithë nxënësit të cilët do të zgjedhin Historinë nga lista e lëndëve të detyruara në provimin ekstern për nxënësit e klasës IX, do të japin provimin të njëjtën ditë dhe në të njëjtën kohë.

Është paraparë që nxënësi të ulet vetëm në bankë dhe që renditja e bankave në klasë të jetë e tillë që më së shumti në një hapësirë të vendosen 15 nxënës.

Materiali i provimit do të paktohet në qese të veçanta dhe të sigurta (PVC), të cilat do të hapen para nxënësve para fillimit të provimit.

Në provim nuk lejohet:

- prezantimi i rrejshëm
- shikimi i detyrave të provimit para kohës së lejuar
- pengimi i nxënësve tjerë
- përshkrimi nga nxënësi tjetër
- shfrytëzimi i mjeteve të palejuara
- mosrespektimi i sinjalit për përfundimin e provimit

Mjetet e lejuara janë: lapsi i thjeshtë, goma, lapsi kimik dhe korrektori.

Punimi i nxënësit duhet të jetë i shkruar me laps kimik.

3. QËLLIMET E PËRGJITHSHME TË PROVIMIT

Qëllimi i provimit ekstern në fund të klasës së nëntë nga Historia është që:

- nxënësi/ja të marrë njohuritë themelore për historinë si shkencë dhe lëndë mësimore,
- nxënësi/ja të zhvillojë aftësitë e të kuptuarit të kohës historike, hapësirës dhe shfrytëzimit të literaturës dhe terminologjisë historike,
- nxënësi/ja të njihet me të gjitha llojet e burimeve historike dhe të tregojë për qasjen e domosdoshme kritike të informatave të cilat ndodhen në to,
- nxënësi/ja të njihet me ngjarjet e rëndësishme, proceset dhe personalitetet politike, ekonomike dhe kulturore të historisë, të cilat shënuan epokat e caktuara historike,
- të afirmojë përmbajtjen nga historia kombëtare me të cilën nxënësi/ja sendërtohet zhvillimi i identitetit kombëtar dhe vetëdija e përkatësisë së bashkësisë shtetërore,
- nxënësi/ja zhvillon aftësinë e mendimit kritik e historik dhe konkluzionit logjik,
- të ndikohet në formimin e personalitetit të nxënësit/es të liruar nga urrejtja, ksenofobia, paragjykimi dhe idealeve nacionaliste si dhe që nxënësin/en ta drejtojë drejt formave demokratike të sjelljes, tolerancës fetare dhe nacionale,
- ta aftësojë nxënësin/en për procesin e arsimimit të përhershëm,
- ta zgjojë interesimin e nxënësit/es për studimin e të së kaluarës, kulturave tjera dhe shfaqjes së mendimeve të ndryshme
- të krahasojë të arriturat e njohurive dhe shkathtësive nga historia në nivelin shkollor, komunal dhe atë nacional.

4. STRUKTURA E PROVIMIT

Numri maksimal i pikëve është **100**. Detyra që nuk është zgjedhë saktë ose ajo që nuk është zhvilluar fare **nuk sjell** pikë negative.

Provimi përmban dy lloje të detyrave:

a) detyrat me zgjedhje të shumëfishtë

b) detyrat e tipit të hapur

Tipi i detyrave	Numri i detyrave
Detyrat e tipit të hapur	
Detyrat e tipit të mbyllur	

Lënda mësimore nga Historia për shkollën fillore është e ndarë në 5 kapituj (fusha). Me tabelë është dhënë përfaqësimi i përmbajtjes në strukturë të provimit.

Numri rendor	Kapitulli	Përfaqësimi i përmbajtjes me %
1.	Hyrje në histori dhe parahistori	5%
2.	Koha e vjetër	15%
3.	Mesjeta	20%
4.	Koha e re	30%
5.	Periodha bashkëkohore	30%

5. PROGRAMI I PROVIMIT

1. Hyrje në histori dhe parahistori

1.1. HYRJE NË HISTORI

Qëllimet e provimit

Nxënësi tregon se di:

1.1.1. të kuptojë konceptin e burimeve historike dhe të përkufizojë llojet e burimeve historike;

1.1.2. të dallojë periudhat e mëdha historike dhe mënyrat e llogaritjes së kohës.

1.2. PARAHISTORIA

Qëllimet e provimit

Nxënësi tregon se di:

1.2.1. të kuptojë mënyrën e jetës së njerëzve dhe di të analizojë format e bashkësisë shoqërore në parahistori;

1.2.2. të kuptojë artin dhe fenë në parahistori

2. KOHA E VJETËR

2.1. LINDJA E VJETËR

Qëllimet e provimit

Nxënësi tregon se di:

2.1.1. të identifikojë territoret dhe lumenjtë rreth të cilëve janë krijuar civilizimet e para të mëdha të Lindjes së lashtë dhe Amerikës;

2.1.2. të analizojë strukturat shoqërore dhe ekonomike dhe të përshkruaj jetën e përditshme të shtresave shoqërore në Egjipt;

2.1.3. të kuptojë rolin e fesë dhe kulturës në shtetet e Lindjes së lashtë.

2.2. GREQIA ANTIKE

Qëllimet e provimit

Nxënësi tregon se di:

2.2.1. të kuptojë shtrirjet e kulturës kreto-mikenase;

2.2.2. të kuptojë mënyrën e jetës së grekëve të vjetër;

- 2.2.3. të përkufizojë sistemin fetar të grekëve të vjetër;
- 2.2.4. të kuptojë procesin e paraqitjes së polisëve;
- 2.2.5. të theksojë shkaqet, drejtimet dhe pasojat e kolonizimit grek;
- 2.2.6. të analizojë strukturat shoqërore dhe ekonomike të Athinës dhe Spartës;
- 2.2.7. të kuptojë shkaqet dhe pasojat e luftërave greko-persiane dhe të Pelopenezit;
- 2.2.8. të përkufizojë ngritjen e shtetit maqedonas, madhësinë dhe rëndësinë e Perandorisë së Aleksandrit të Madh;
- 2.2.9. të vlerësojë të arriturat më të mëdha të kulturës greke dhe maqedonase.

2.3. ROMA ANTIKE

Qëllimet e provimit

Nxënësi tregon se di:

- 2.3.1 të përmend territorin ku dhe në ç' mënyrë është krijuar Roma;
- 2.3.2. të kuptojë marrëdhëniet e patricëve dhe plebejëve;
- 2.3.3. të kuptojë rregullimin shtetëror dhe shoqëror në kohën e Republikës
- 2.3.4. të përkufizojë organizimin e ushtrisë romake dhe të kuptojë organizimin e territoreve të pushtuara;
- 2.3.5. të përmend pushtimet romake në kohën e Republikës;
- 2.3.6. të kuptojë organizimin shoqëror dhe ekonomik të perandorisë;
- 2.3.7. të analizojë jetën e përditshme të shtresave të ndryshme të shoqërisë romake;
- 2.3.8. të kuptojë shkaqet e krizës së Perandorisë Romake dhe ndarjet dhe rëniet e saj;
- 2.3.9. të njohë të arriturat më të rëndësishme të kulturës romake dhe sistemin fetar të tyre;
- 2.3.10. të analizojë rolin e krishterimit në shtetin romak;
- 2.3.11. të kuptojë sistemin e qeverisjes romake dhe procesin e romanizimit në territorin e sotëm të Malit të Zi.

3. MESJETA

3.1. MESJETA E HERSHME

Qëllimet e provimit

Nxënësi tregon se di:

- 3.1.1. të sqarojë kuptimin dyndja e madhe e popujve dhe ndikimin e saj në rrjedhat e mëtejshme historike;
- 3.1.2. të përmend ngjashmëritë dhe ndryshimet në mes të shoqërisë skllavopronare dhe feudale;
- 3.1.3. të veçojë shtresat shoqërore në shtetet e krijuara në territorin e Perandorisë Romake të Perëndimit;
- 3.1.4. të identifikojë shkaqet që i mundësuan Bizantit ta tejkalojë krizën e shkaktuar nga dyndja e madhe e popujve;
- 3.1.5. të kuptojë ndikimin ekonomik, fetar dhe kulturor të Bizantit në popujt e sllavëve të jugut;
- 3.1.6. të numërojë qendrat e rëndësishme krishtere dhe të sqarojë përse erdhi deri te ndarja e Romës dhe Stambollit;
- 3.1.7. të përkufizojë rregullimin e kishës së krishterë në perëndim dhe në lindje dhe të kuptojë shkaqet e konfliktit që sjell në ndarjen e kishës;
- 3.1.8. të kuptojë kushtet e krijimit dhe veçoritë themelore të islamit si fe botërore;
- 3.1.9. të përkufizojë të arriturat e rëndësishme të kulturës arabe dhe ndikimin e saj në rrjedhat kulturore të Evropës;
- 3.1.10. të përmend ngjashmëritë dhe dallimet në mes të krishterimit dhe islamit;

3.2. SLLAVËT E JUGUT NË MESJETËN E HERSHME

Qëllimet e provimit

Nxënësi tregon se di:

- 3.2.1. të identifikojë shkaqet dhe drejtimin e dyndjes së Sllavëve të vjetër;
- 3.2.2. të përmend popujt që u përkasin Sllavëve të Lindjes, Perëndimit dhe të Jugut;
- 3.2.3. të kuptojë marrëdhëniet e Bizantit me Sllavët e Jugut me rastin e popullimit të Ballkanit;
- 3.2.4. të analizojë misionin e vëllezërve të Selanikut Konstantinit dhe Methodies;
- 3.2.5. të përmend territoret ku është krijuar Karantania dhe të sqarojë mënyrën se si e ka humbur pavarësinë;
- 3.2.6. të përmend territorin në të cilin është krijuar Kroacia dhe të sqarojë mënyrën e hyrjes së saj në bashkësi me Hungarinë;

- 3.2.7. të përmend territorin në të cilin është krijuar Rashka;
- 3.2.8. të analizojë faktorët e brendshëm dhe të jashtëm të cilët kanë ndikuar në zhvillimin e Rashkës nga mbreti Vllastimir deri te vdekja e mbretit Çasllav Kllonimiroviq;
- 3.2.9. të përmend territorin në të cilin është krijuar shteti i Sllavëve të Duklës;
- 3.2.10. të analizojë statusin e Duklës në kuadër të shtetit Maqedonas gjatë kohës së sundimit të mbretit Vlladimir;
- 3.2.11. të vlerësojë rëndësinë e betejës së Tivarit për fitimin e pavarësisë së Duklës;
- 3.2.12. të identifikojë ngjarjet kryesore historike që i kanë parapri shpalljes së Zetës mbretëri;
- 3.2.13. të veçojë monumentet materiale dhe monumentet e shkruara historike të Duklës-Zetës në mesjetë;
- 3.2.14. të analizojë rrethanat politike në Zetë nga vdekja e Bodinit deri te rënia e saj.

3.3. EUROPA NË KOHËN E MESJETËS SË ZHVILLUAR

Qëllimet e provimit

Nxënësi tregon se di:

- 3.3.1. të analizojë rëndësinë e tregtisë, zejtarisë dhe veprimeve bankare në zhvillimin e qyteteve mesjetare;
- 3.3.2. të theksojë rëndësinë e paraqitjes së qyteteve europiane të mesjetës për zhvillimin e shoqërisë dhe shtetit në mesjetën e zhvilluar;
- 3.3.3. të shpjegojë si paraqitet monarkia shtresore dhe mënyrën në të cilën kuvendi shtresor u kufizonte pushtetin sundimtarëve;
- 3.3.4. të vlerësojë kërkesën e jeretëve që kisha e krishterë t'i kthehet varfërisë së hershme krishtere dhe riteve të para të thjeshta krishtere;
- 3.3.5. të analizojë shtresat shoqërore në shtetet e mesjetës së zhvilluar;
- 3.3.6. të veçojë faktet të cilat vërtetojnë që motivet e luftës së katërt të kryqëzatave janë të natyrës materiale, e jo fetare;
- 3.3.7. të kuptojë hierarkinë kishtare në kishën ortodokse;
- 3.3.8. të vlerësojë rëndësinë e rënies së Bizantit në Gadishullin e Ballkanit;

3.3.9. të përmend ngjarjen dhe vitin kur është zhdukur Bizanti nga skena historike;

3.4. SLLAVËT E JUGUT NGA SHEKULLI XII DERI NË MESIN E SHEKULLIT TË XIV

Qëllimet e provimit

Nxënësi tregon se di:

3.4.1. të njohë përtëritësin e shtetit serb në mesjetë, dhe territorin që përfshinte ky shtet;

3.4.2. të kuptojë rëndësinë e hapjes së minierës për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të Serbisë së mesjetës;

3.4.3. të numërojë sunduesit e dinastisë së Nemanjiqëve dhe titujt që mbanin;

3.4.4. të përshkruaj marrëdhëniet shoqërore dhe ekonomike dhe rregullimin juridik të legjislacionit të Dushanit;

3.4.5. të kuptojë pozitën e privilegjuar të Zetës në shtetin e Nemanjiqëve;

3.4.6. të cek se çka ka ndikuar në depërtimin e ndikimit fetar ortodoks në territorin e Zetës;

3.4.7. të numërojë objektet e rëndësishme fetare të ngritura në kohën e sundimit të Nemanjiqëve në territorin e sotëm të Malit të Zi;

3.4.8. të përmend territorin e krijimit të shtetit mesjetar të Bosnjës;

3.4.9. të kuptojë rrethanat shoqërore, ekonomike dhe fetare në Bosnjën mesjetare;

3.4.10. të përmend faktet të cilat tregojnë në se Dubrovniku ka qenë qendra më e rëndësishme ekonomike në bregdetin jugor të sllavëve;

3.5. GADISHULLI BALLKANIK NË KOHËN E PUSHTIMEVE OSMANE OSVAJANJA

Qëllimet e provimit

Nxënësi tregon se di:

3.5.1. të vërejë hapësirën në të cilën është krijuar Perandoria Osmane dhe të kuptojë rrethanat shoqërore-politike në Ballkan në prag dhe pas pushtimeve të turqve;

3.5.2. të krahasojë rrethanat në Serbi para betejës së Kosovës me rrethanat pas luftës në Kosovë;

3.5.3. të përkufizojë rrethanat kulturore në kohën e Despotisë;

- 3.5.4. të përshkruaj gjendjen në Bosnje nga vdekja e Tvrtkut deri te rënia nën pushtetin turk;
- 3.5.5. të theksojë hapësirën në të cilën Shqiptarët kanë ruajtur autoktoninë e tyre dhe të kuptojë rrethanat shoqëro-politike deri te ardhja e Osmanlinjve;
- 3.5.6. të kuptojë rrethanat shoqërore në kohën e sundimit të Ballshajve;
- 3.5.7. të identifikojë të arriturat ekonomike dhe kulturore në kohën e sundimit të Ballshajve;
- 3.5.8. të përshkruaj rrethanat në Zetë në kohën e ardhjes në pushtet të familjes feudale të Crnojeviqëve;
- 3.5.9. të veçojë ngjarjet e rëndësishme të cilat kishin të bënin me kohën e sundimit të Ivan dhe Gjuraq Cërnojeviqit;
- 3.5.10. të përshkruaj kulturën e mesjetës;

4. KOHA E RE

4.1. LINDJA E EUROPËS MODERNE

Qëllimet e provimit

Nxënësi tregon se di:

- 4.1.1. të përmend zbulimet më të rëndësishme teknike, shkencore dhe gjeografike;
- 4.1.2. të sqarojë ndryshimet të cilat janë paraqit në art, shkencë, letërsi, arkitekturë dhe në jetën e përditshme me ringjalljen e humanizmit dhe renesancës;
- 4.1.3. të identifikojë krijuesit më të rëndësishëm nga periudha e humanizmit dhe renesancës;
- 4.1.4. të analizojë shkaqet dhe pasojat e reformimit të kishës së krishterë romake;
- 4.1.5. të kuptojë shkakun dhe pasojat e zbulimeve të mëdha gjeografike;
- 4.1.6. të dallojë tri fuqitë më të mëdha në Ballkan në shekullin e XVI dhe në shekullin e XVII dhe të kuptojë organizimin e pushtetit të tyre;
- 4.1.7. të gjejë ngjashmëri dhe dallime në aspektin e qeverisjes shtetërore, organizimit administrativ, fuqive ushtarake, rrethanave ekonomike, shoqërore dhe kulturore në Perandorinë Osmane, Republikën e Venedikut dhe në Monarkinë e Habsburgëve;
- 4.1.8. të përshkruaj pozitën e popullatës së sllavëve të jugut nën pushtimin e të huajve në shekullin XVI dhe në shekullin XVII;
- 4.1.9. të dallojë format e rezistencës së popullatës pushtetit të huaj.

4.2. SHOQËRIA FISNORE NË MAL TË ZI

Qëllimet e provimit

Nxënësi tregon se di:

- 4.2.1. të shpjegojë pozitën specifike të Malit të Zi nën sundimin osman;
- 4.2.2. të analizojë organizimin dhe veçoritë e shoqërisë fisnore malazeze;
- 4.2.3. të theksojë rëndësinë e mitropolisë së Cetinës në shoqërinë fisnore malazeze;
- 4.2.4. të dallojë luftën e malazëve për mbrojtjen e privilegjeve të fituara nga lufta për çlirimin nacional;
- 4.2.5. të përmend në mënyrë kronologjike luftërat Venediko-osmane në të cilat kanë marrë pjesë malazët në anën e Venedikut;
- 4.2.6. të kuptojë rëndësinë e ardhjes së mitropolitit Danilo Petroviq në krye të mitropolisë së Cetinës;
- 4.2.7. të vlerësojë rëndësinë e vendosjes së lidhjeve të Malit të Zi me Rusinë;
- 4.2.8. të shpjegojë si lufta e malazëve për mbrojtjen e privilegjeve të fituara filloi të kalojë në luftë nacionale për çlirim;
- 4.2.9. të përmend në mënyrë kronologjike pushtetarët malazez nga dinastia Petroviq-Njegosh;
- 4.2.10. të vlerësojë dhe të përmbledhë në mënyrë kritike sundimin e Shqepanit të Vogël me Malin e Zi.

4.3. LUFTËRAT PËR PAVARËSI DHE EMANCIPIM TË QYTETARËVE

Qëllimet e provimit

Nxënësi tregon se di:

- 4.3.1. të shpjegojë dallimin në mes të monarkisë shtresore dhe asaj absolute;
- 4.3.2. të kuptojë kushtet e shpërthimit të revolucioneve të para qytetare në Botë;
- 4.3.3. të vërejë shkaqet e luftës për pavarësi dhe krijim të SHBA-ve;
- 4.3.4. të analizojë ndarjen shtresore në Francë, posaçërisht pozitën e të ashtuquajturës “shtresës së tretë”;
- 4.3.5. të kuptojë rëndësinë e revolucionit francez;
- 4.3.6. të përmend betejat më të njohura që ka udhëhequr Napoleoni;

- 4.3.7. të kuptojë ndarjen politike pas Kongresit të Vjenës;
- 4.3.8. të kuptojë rrethanat në pashallëkun e Beogradit në fillim të shekullit XIX;
- 4.3.9. të analizojë rëndësinë e kryengritjeve të para në Ballkan;
- 4.3.10. të njohë dallimet në rrugët e luftërave të Karagjorgjes dhe Millosh Obrenoviqit;
- 4.3.11. të njohë rolin e Petrit I në krijimin e shtetit malazez;
- 4.3.12. të kuptojë rëndësinë e fitoreve të mëdha të malazezëve në Martinique dhe në Kruse;
- 4.3.13. të vlerësojë rëndësinë e sjelljes së Kanunit malazez të maleve në procesin e krijimit të shtetit të Malit të Zi;
- 4.3.14.** të argumentojë kushtet e bashkimit të Malit të Zi dhe Bokës në vitin 1813.

4.4. EVROPA NË PJESËN E PARË TË SHEKULLIT XIX

Qëllimet e provimit

Nxënësi tregon se di:

- 4.4.1. të përkufizojë revolucionin industrial dhe pasojat e tij;
- 4.4.2. të përkufizojë Aleancën e Shenjtë si aleancë ushtarako-politike dhe të theksojë qëllimet e saj;
- 4.4.3. të emërojë shkaqet e revolucionit 1848 dhe pasojat e tij;
- 4.4.4. të kuptojë pozitën dhe pozitën politike të popujve të Ballkanit të cilët në pjesën e parë të shekullit XIX kanë jetuar brenda kornizave të Perandorisë Osmane dhe Monarkisë së Habsburgëve;
- 4.4.5. të përkufizojë format e luftës politike të popujve të Ballkanit për çlirimin kombëtar.

4.5. FORCIMI I INSTITUCIONEVE SHTETËRORE NË MAL TË ZI

Qëllimet e provimit

Nxënësi tregon se di:

- 4.5.1. të kuptojë riorganizimin e pushtetit në Mal të Zi në kohën e Petrit II;
- 4.5.2. të përkufizojë kontributin e Njegoshit zhvillimit kulturor të Malit të Zi;

- 4.5.3. të shpjegojë kthesën historike e cila pasoi në Mal të Zi me ndarjen e pushtetit religjioz nga ai laik në kohën e ardhjes në pushtet të Danillo Petroviq Njegosh;
- 4.5.4. të njohë shkaqet për sulmin e parë të Omer Pashës në Mal të Zi, si dhe pasojat e atij sulmi;
- 4.5.5. të sqarojë rëndësinë e betejës në Grahovc dhe verifikimin ndërkombëtar të kufizimit të Malit të Zi me Perandorinë Osmane.

4.6. KRIJIMI I SHTETEVE NACIONALË DHE ÇËSHTJA E LINDJES

Qëllimet e provimit

Nxënësi tregon se di:

- 4.6.1. të analizojë procesin e bashkimit të Italisë dhe Gjermanisë;
- 4.6.2. të kuptojë shkaqet për sjelljen e marrëveshjes së Austro-Hungarisë nga viti 1867;
- 4.6.3. të vërejë dallimet në zhvillimin ekonomik të SHBA-ve si dhe rëndësinë e luftës qytetare;
- 4.6.4. të analizojë rrethanat në Rusi në mes të shekullit XIX;
- 4.6.5. të njohë lëvizjet nacionale në Ballkan;
- 4.6.6. të përkufizojë çështjen e Lindjes;
- 4.6.7. të përshkruaj sundimin e princit Nikollë deri në vitin 1876;
- 4.6.8. të përmend betejat kryesore nga „Lufta e Madhe“;
- 4.6.9. të lidhë sukseset luftarake të Malit të Zi në „Luftën e Madhe“ me njohjen ndërkombëtare;
- 4.6.10. të theksojë vendimet w Kongresit të Berlinit.

4.7. RRETHANAT NË BALLKAN PAS KONGRESIT TË BERLINIT

Qëllimet e provimit

Nxënësi tregon se di:

- 4.7.1. të analizojë ngjarjet më të rëndësishme shoqëro-politike në Ballkan nga viti 1878 deri në vitin 1912;
- 4.7.2. të përshkruaj veprimtarinë politike të Austro-Hungarisë pas Kongresit të Berlinit;
- 4.7.3. të vlerësojë rëndësinë e Komplotit të majit në Serbi në planin e brendshëm dhe të jashtëm;
- 4.7.4. të analizojë zhvillimin ekonomik të Malit të Zi nga Kongresi i Berlinit;

4.7.5. të shpjegojë ndryshimet të cilat janë paraqitur me reformën e administratës shtetërore në vitin 1878 dhe më pas;

4.7.6. të kuptojë procesin e islamizimit dhe pozitën e myslimanëve në Mal të Zi.

4.8. PAQJA E PAQËNDRUESHME

Qëllimet e provimit

Nxënësi tregon se di:

4.8.1. të vërejë shkaqet për krijimin e blloqeve ushtarako-politike si dhe dallimet në mes tyre;

4.8.2. të kuptojë rëndësinë e krijimit të Federatës Ballkanike;

4.8.3. të theksojë krizat ndërkombëtare në fillim të shekullit XX;

4.8.4. të përmend betejat kryesore në luftërat ballkanike;

4.8.5. të kuptojë rëndësinë e luftërave ballkanike.

4.9. MALI I ZI – MONARKIA KUSHTETUESE

Qëllimet e provimit

Nxënësi tregon se di:

4.9.1. të theksojë rëndësinë e miratimit të kushtetutës së vitit 1905 për zhvillimin e parlamentarizmit në Mal të Zi;

4.9.2. të analizojë aferën me bomba dhe procesin e Kollashinit;

4.9.3. të vërejë kushtet për shpalljen e Malit të Zi mbretëri;

4.9.4. të dallojë qëllimet e luftës së Malit të Zi në Luftën e Parë Ballkanike dhe të përmend betejat kryesore;

4.9.5. të vlerësojë humbjet malazeze rreth Shkodrës dhe ndikimet e tyre për zhvillimin e mëtejshëm shoqëroro-politik dhe demografik të Malit të Zi;

4.9.6. të përshkruaj zgjerimin territorial të Malit të Zi pas luftërave ballkanike;

4.9.7. të analizojë zhvillimin kulturor dhe arsimor të Malit të Zi nga viti 1878 deri në vitin 1912 dhe të theksojë të arriturat kulturore më të rëndësishme.

5. KOHA BASHKËKOHORE

5.1. LUFTA E PARË BOTËRORE

Qëllimet e provimit

Nxënësi tregon se di:

- 5.1.1. të caktojë shkaqet dhe arsyet e shpërthimit të Luftës së Parë Botërore;
- 5.1.2. të identifikojë palët në konflikt dhe t'i theksojë qëllimet e tyre luftarake;
- 5.1.3. të theksojë betejat më të rëndësishme në Luftën e Parë Botërore;
- 5.1.4. të kuptojë karakterin e Luftës së Parë Botërore;
- 5.1.5. të krahasojë ngjashmëritë dhe dallimet në mes të Revolucionit të Shkurtit dhe Tetorit;
- 5.1.6. të përshkruajë operacionet e ushtrisë malazeze dhe ushtrisë serbe në Luftën e Parë Botërore;
- 5.1.7. të analizojë gjendjen në Mal të Zi pas hyrjes së trupave aleate;
- 5.1.8. të analizojë rolin e qeverisë serbe, Këshillit të Jugosllavisë, Deklaratës së Majit, Deklaratës së Korfuzit dhe Këshillit Nacional.

5.2. BOTA NË MES TË DY LUFTËRAVE BOTËRORE

Qëllimet e provimit

Nxënësi tregon se di:

- 5.2.1. të theksojë vendimet më të rëndësishme të Konferencës së Paqes në Paris;
- 5.2.2. të kuptojë shkaqet e themelimit të Shoqatës së popujve dhe organizimin e saj;
- 5.2.3. të përmend sistemet e ndryshme shoqërore në Evropë në mes të dy luftërave botërore;
- 5.2.4. të përkufizojë karakteristikat themelore të sistemeve shoqërore në Evropë në mes të dy luftërave botërore;
- 5.2.5. të kuptojë pozitën specifike të Shqipërisë dhe shqiptarëve në këtë periudhë.

5.3. MBRETËRIA E SKS/JUGOSLLAVIA

Qëllimet e provimit

Nxënësi tregon se di:

- 5.3.1. të kuptojë organizimin administrativ dhe territorial të Mbretërisë së SKS;

5.3.2. të përmend subjektet më të njohura politike dhe udhëheqësit e tyre në Mbretërinë e SKS;

5.3.3 të kuptojë shkaqet dhe pasojat e futjes së diktaturës së gjashtë janarit;

5.3.4. të analizojë marrëdhëniet shoqërore në Mbretërinë e Jugosllavisë pas vrasjes së Mbretit Aleksandër;

5.3.5. të analizojë çështjen nacionale në Mbretërinë e SKS;

5.3.6. të analizojë pozitën e Malit të Zi në Mbretërinë e SKS/Jugosllavisë.

5.4. LUFTA E DYTË BOTËRORE 1939-1945

Qëllimet e provimit

Nxënësi tregon se di:

5.4.1. të identifikojë shkaqet për shpërthimin e Luftës së Dytë Botërore;

5.4.2. të theksojë qëllimet ushtarake të palëve në konflikt;

5.4.3. të vlerësojë rëndësinë e Kartës së Atlantës;

5.4.4. të përmend frontet dhe betejat më të rëndësishme të Luftës së Dytë Botërore;

5.4.5. të analizojë pozitën e popullatës civile në Luftën e Dytë Botërore.

5.5. JUGOSLLAVIA NË LUFTËN E DYTË BOTËRORE

Qëllimet e provimit

Nxënësi tregon se di:

5.5.1. të kuptojë okupimin dhe ndarjen e Jugosllavisë;

5.5.2 të analizojë luftën e popujve të Jugosllavisë kundër okupatorit;

5.5.3. të informojë për lëvizjet kuislinge dhe regjimet në Jugosllavi;

5.5.4. të vlerësojë karakterin e luftës në Jugosllavi;

5.5.5. të kuptojë ndryshimin revolucionar të pushtetit në Jugosllavi.

5.5.6. të analizojë rëndësinë e Kryengritjes së 13 korrikut;

5.5.7. të shpjegojë karakteristikat themelore të sistemit okupues italian në Mal të Zi;

5.5.8. të analizojë rëndësinë e themelimit të Këshillit Antifashist Çlirimtar Popullor për Mal të Zi dhe Bokë;

5.5.9. të vlerësojë në mënyrë kritike humbjet në njerëz dhe humbjet materiale të Malit të Zi në Luftën e Dytë Botërore.

5.6. BOTA NË PJESËN E DYTË TË SHEKULLIT XX

Qëllimet e provimit

Nxënësi tregon se di:

5.6.1. të kuptojë shkaqet e themelimit të OKB-së dhe organizimin e saj;

5.6.2. të përmend bllloqet ushtarako-politike pas Luftës së Dytë Botërore dhe të theksojë qëllimet e tyre;

5.6.3. të shpjegojë procesin e dekolonizimit dhe neokolonializmit;

5.6.4. të përmend format e reja të integritimeve evropiane;

5.6.5. të kuptojë rregullimin e Jugosllavisë së pasluftës;

5.6.6. të analizojë proceset e rindërtimit të vendit, reformat agrare, nacionalizimet e pasluftës;

5.6.7. të shpjegojë fenomenin e inforbyrosë;

5.6.8. të kuptojë zhvillimin shoqëror dhe ekonomik të Jugosllavisë në periudhën e vetëqeverisjes;

5.6.9. të analizojë rolin e Josip Broz Titos;

5.6.10. të analizojë pozitën e Malit të Zi në Jugosllavinë socialiste;

5.6.11. të kuptojë rrjedhat shoqërore dhe ekonomike në Mal të Zi gjatë decenieve të para të pasluftës;

5.6.12. të analizojë faktorët që kanë shkaktuar shkatërrimin e shtetit jugosllav.

6. SHEMBULLI I TESTIT ME SKEMË PËR VLERËSIM

Në detyrat në vazhdim qarkoni shkronjën para përgjigjes së saktë.

1. Spartën e ka themeluar fisi grek:

- A) Ahaj
- B) Dor
- C) Eol
- D) Jon

1 pikë

2. Territoret që i kanë pushtuar romakët ishin të organizuara si:

- A) Shtete të reja
- B) Provinca
- C) Republika
- D) shtete aleate

1 pikë

3. Rënia e Perandorisë Romake të Perëndimit ndodhi në vitin:

- A) 276
- B) 376
- C) 476
- D) 576

1 pikë

4. Mbretëria që e themeluan Kryqtarët pas luftës së katërt të kryqëzatës quhej:

- A) Latine
- B) Nikeje
- C) Osmane
- D) Persiane

1 pikë

5. Monumentet më të rëndësishme të shtetit mesjetar të Bosnjës ishin:

- A) Kishat
- B) Manastiret
- C) Steqet
- D) Xhamitë

1 pikë

6. Humanizmi dhe renesanca janë paraqitur në:

- A) Itali
- B) Angli
- C) Gjermani
- D) Spanjë

1 pikë

7. Themeluesi i dinastisë së Petroviqëve ishte:

- A) Vlladika Danillo
- B) Vlladika Vasilije
- C) Vlladika Petar I
- D) Mbreti Danillo

1 pikë

8. Stega është:

- A) Marrëveshja në mes të malazezëve dhe osmanlinjve
- B) Kuvendi malazez
- C) Betimi i malazezëve dhe malësorëve
- D) organ i pushtetit në Mal të Zi

1 pikë

9. Cila luftë përfundon me Paqen e Parisit në vitin 1856?

- A) Lufta e Baltikut
- B) Lufta e Greqisë
- C) Lufta e Korsikës
- D) Lufta e Krimesë

1 pikë

10. Mali i Zi e fitoi kushtetutën e parë në vitin:

- A) 1805
- B) 1810
- C) 1905
- D) 1910

1 pikë

11. Me komplotin e Majit në pushtet në Serbi vijnë:

- A) Karagjorgjeviqët
- B) Kllonimiroviqët
- C) Nemanjiqët
- D) Obrenovoiqët

1 pikë

12. Qëllimet luftarake të Serbisë në Luftën e Parë Botërore u shpallën me deklaratën e qeverisë dhe Kuvendit Popullor. Kjo deklaratë është e njohur si:

- A) Deklarata e Beogradit
- B) Deklarata e Korfuzit
- C) Deklarata e Nishit
- D) Deklarata e Gjenevës

1 pikë

13. Mbretëria SKS/Jugosllavia / kishte shumë probleme. Cili nga ta ishte më i madhi?

- A) kulturor
- B) nacional
- C) ekonomik
- D) social

1 pikë

14. Sa shtete anëtare numëron sot Bashkimi Evropian?

- A) 23
- B) 25
- C) 27
- D) 29

1 pikë

15. Në procesin e shkatërrimit të Jugosllavisë, viteve të nëntëdhjeta të shekullit të kaluar, ndodhen konflikte e armatosura luftarake. Cili qytet i Kroacisë kishte humbje më të mëdha njerëzore dhe materiale?

- A) Dubrovniku
- B) Osjeku
- C) Sisaku
- D) Vukovari

1 pikë

Në detyrat në vazhdim çdo kuptimi nga kolona e majtë mund t'i bashkoni vetëm një kuptim nga kolona e djathtë. Mbi vija pranë numrit që tregon kuptimin në kolonën e majtë shkruani shkronjën e përgjigjes së saktë nga kolona e djathtë. Keni kujdes, një përgjigje në anën e djathtë është e tepërt!

16. Bashkoni!

- | | |
|------------|-------------------------------|
| 1) Apoloni | A) zoti i rrufesë dhe stuhisë |
| 2) Aresi | B) zoti i urtisë |
| 3) Hermes | C) zoti i luftës |
| 4) Zeusi | D) zoti i diellit |
| | E) zoti i tregtisë |

1) _____

2) _____

3) _____

4) _____

4 pikë

17. Bashkoni detarët gjegjës me zbulimet përkatëse.

- | | |
|------------------|----------------------------|
| 1. Magelani | A) Amerika |
| 2. Kolumbo | B) Australia |
| 3. Vasko de Gama | C) Udhëtimi rreth botës |
| | D) Udhë detare për në Indi |

1) _____

2) _____

3) _____

3 pikë

18. Bashkoji partitë politike në Mbretërinë SKS me udhëheqësit e tyre.

- | | |
|----------------------------------|----------------------|
| 1. Partia fshatare kroate | A) Lubomir Davidoviq |
| 2. Partia demokratike jugosllave | B) Antun Koroshec |
| 3. Partia popullore radikale | C) Nikolla Pashiq |
| 4. Partia njerëzore sllovene | D) Punisha Raçiq |
| | E) Stjepan Radiq |

1) _____

2) _____

3) _____

4) _____

4 pikë

**Lexoni me kujdes pohimet e dhëna dhe caktoni nëse janë ato të sakta (S) ose të pasakta (P).
Qarkoni (S) nëse mendoni se pohimi është i saktë, përkatësisht (P) nëse pohimi është i pasaktë.**

19. Janë dhënë pohimet nga historia e Egjiptit.

- | | | |
|--|---|---|
| A) Lumi Nil çdo vit derdhet në të njëjtat distanca kohore. | S | P |
| B) Nomet janë shtete të mëdha. | S | P |
| C) Epoka historike në Egjipt fillon me gjetjen e shkrimit. | S | P |
| D) Shkrimi i Egjiptit quhet kuniform. | S | P |


4 pikë

Pyetjet e tipit të hapur:

20. Plotësoje fjalinë:

Dëshminë për të kaluarën e njerëzimit e quajmë _____.

1 pikë



21. Plotësoje fjalinë:

Në fotografi është paraqitur (1) _____ i cili konsiderohet (2) _____.

2 pikë

22. Plotësoje fjalinë:

Përçarja e madhe në kishën e krishterë ka ndodhur në shekullin (1) _____. Katolicizmi është ndarë në kishën (2) _____ dhe (3) _____.

3 pikë

23. Plotësoje fjalinë:

Nacionet dhe ngjarjet: „ Pirja e çajit në Boston“, beteja te Jorktauni dhe 4 korriku lidhen me _____.

1 pikë

24. Plotësoje fjalinë:

Humbjen e parë forcat e Napoleonit e kanë pësuar nga (1) _____, kur flota e tij është mundur në betejën detare të (2) _____ në vitin 1805.

2 pikë

25. Pas fitores në Martiniqe dhe në Kruse fillon procesi i bashkimit të Malit të Zi me Malet. Malit të Zi së pari në vitin 1796 i bashkohet (1) _____ dhe (2) _____ kurse më vonë në vitin 1830 (3) _____ dhe (4) _____.

4 pikë

26. Plotësoji fjalitë:

Me vendimin e Kongresit të Berlinit Bosnja dhe Hercegovina është(1) _____ nga ana e Austro- Hungarisë. Austro – Hungaria ka bërë (2) _____ e Bosnjës dhe Hercegovinës në vitin 1908.

2 pikë

27. Malin e Zi në Luftën e Parë Botërore e ka okupuar ushtria e (1) _____. Kundër asaj gjendjeje është organizuar rezistenca ushtarake që quhet lëvizja e (2) _____ .

2 pikë

28. Plotësoje fjalinë:

Ahmet Zogu pas shtypjes së pushtetit demokratik në vitin 1924, drejton me Shqipërinë si (1) _____, kurse nga viti 1928 si (2) _____.

2 pikë

29. Në shiritin e kohës shëno me vija periudhën e mesjetës.

III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	XIII	XIV	XV	XVI	XVII
-----	----	---	----	-----	------	----	---	----	-----	------	-----	----	-----	------

1 pikë

30. Renditi sipas radhës kronologjike sundimtarët e Duklës duke shkruar pranë numrit rendor shkronjën e cila ndodhet para emrit të sundimtarit që i përgjigjet numrit rendor.

- A. Vlladimiri
- B. Mihaillo
- C. Petri
- D. Bodini
- E. Vojisllavi

1. _____

2. _____

3. _____

4. _____

5. _____

4 pikë

31. Renditi sipas radhës kronologjike betejat që janë zhvilluar gjatë Luftës së Dytë Botërore.

- A) beteja te El Allamejna
- B) sulmi në Perl Harbur
- C) zbarkimi në Normandi
- D) "beteja e çelikut"

1. _____

2. _____

3. _____

4. _____

3 pikë


32. Sipas materialit nga i cili njerëzit kanë bërë armët parahistoria ndahet në:

A) _____

B) _____

2 pikë

33. Cilit stil të arkitekturës greke i takojnë këto stilet?



A) _____

B) _____

2 pikë

34. Popullata në kohën e Republikës së Romës ndahej në:

A) _____

B) _____

2 pikë

35. Pranë vitit shëno ngjarjen e rëndësishme me të cilin ka të bëjë ai:

A) 476 _____

B) 622 _____

C) 1054 _____


D) 1077 _____

4 pikë

36. Të kujt janë veprat e përshtirshme të manastireve në vazhdim:



A) Studenica _____



B) Zhica _____



C) Sopoqani _____

3 pikë

37. Për shkak të zhvillimit ekonomik dhe politik të Evropës dhe Mesdheut janë veçuar tre breza kulturor. Thuaj cilët.

A) _____

B) _____

C) _____

3 pikë

38. Thuaj tri fuqitë më të mëdha në Ballkan në shekullin XVI dhe në shekullin XVII:

A) _____

B) _____

C) _____

3 pikë

39. Gjatë revolucionit francez janë formuar 2 klube borgjeze dhe ato janë:

A) _____

B) _____

2 pikë

40. Thuaj shkakun e shpërthimit të kryengritjes së parë serbe dhe cili ishte motivi i saj.

_____.

2 pikë

41. Cilat organe të pushtetit i ka formuar Petri II në Mal të Zi?

A) _____

B) _____

C) _____

3 pikë

42. Cili shtet ka luajt rolin udhëheqës në procesin e bashkimit të Italisë?

A) _____

Cili shtet ka luajt rolin udhëheqës në procesin e bashkimit të Italisë?

B) _____

2 pikë

43. Zakonisht betejat e luftës kanë edhe fituesin e tyre. Në një nga betejat në Luftën e Parë Botërore të dy palët e përfshira në luftë janë shpallë fituese.

A) Cila betejë është në pyetje? _____

B) Cilat palë ndërluftuese kanë marrë pjesë në betejë? _____

2 pikë

44. Thuaj tri shtete të cilat janë formuar pas Luftës së Parë Botërore.

A) _____

B) _____

C) _____

3 pikë

45. Shteti i ardhshëm do të jetë monarki kushtetuese parlamentare nën pushtetin e dinastisë Karagjorgjeviq, qëndron në Deklaratën e Korfuzit. Kush mori pjesë në bisedime, rezultati i të cilave ka qenë Deklarata e Korfuzit?

A) _____

B) _____

2 pikë

46. Thuaj sistemet shoqërore në disa vende, ndërmjet dy luftërave botërore.

A) Francë _____

B) BRSS _____

C) Itali _____

3 pikë

47. Mali i Zi në ndarjen administrative të Mbretërisë SKS/Jugosllavisë ishte në përbërje:

A) Nga 1922-1929 _____

B) Nga 1929-1941 _____

2 pikë

48. Lufta e Dytë Botërore në Jugosllavi kishte veçori të shumta të cilat e përkufizojnë karakterin e sajë të trefishtë. Thuaj tri karakteristikat kryesore të sajë.

A) _____

B) _____

C) _____

3 pikë

PËRGGJIGJET ME SKEMË PËR PIKËSIM

1. Nën B) Dorët - 1 pikë
2. Nën B) Provincat – 1 pikë
3. Nën C) viti 476 – 1 pikë
4. Nën A) Latin 1 pikë
5. Nën C) Steqët – 1 pikë
6. Nën A) Italisë 1 pikë
7. Nën A) Vlladika Danillo 1 pikë
8. Nën C) betimi i malazezëve dhe malësorëve
9. Nën D) Lufta e Krimesë - 1 pikë
10. Nën C) 1905 1 pikë
11. Nën A) Karagjorgjeviqët
12. Nën C) Deklarata e Nishit
13. Nën B) nacional
14. Nën C) 27
15. Nën D) Vukovari
16. 1-D 1 pikë
2-C 1 pikë
3-E 1 pikë
4-A 1 pikë
17. 1-C 1 pikë
2-A 1 pikë
3- D 1 pikë

18. 1-E 1 pikë

2-A 1 pikë

3-C 1 pikë

4-B 1 pikë

19. A) S - 1 pikë

B) P - 1 pikë

C) S - 1 pikë

D) P - 1 pikë

20. Burimet historike 1 pikë

21. 1- Herodoti – 1 pikë

2 – baba i historisë - 1 pikë

22. 1 -XI – 1 pikë

2 – katolike(katolike romake- perëndimore) -1 pikë

3 - ortodokse (të lindjes) dhe anasjelltas mbi vijën e dytë dhe të tretë.

23. Lufta për pavarësi (formimin e SHBA-ve) 1 pikë

24. 1- Britania e Madhe (pranohet edhe Anglisë) 1 pikë

2- Trafalgarëve 1. bod

25. 1.- Bjellopavliqi 1 pikë

2. – Pipri 1 pikë

3. – Moraça 1 pikë

4. – Rovci 1 pikë

26. 1- e okupuar 1 pikë

2. aneksuar 1 pikë

27. 1- Austro-Hungaria 1 pikë

2.- i komitëve 1 pikë

28. 1- kryetari i qeverisë 1 pikë

2- fund 1 pikë

29. Përgjigjja sjell 1 pikë

III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	XIII	XIV	XV	XVI	XVII
-----	----	---	----	-----	------	----	---	----	-----	------	-----	----	-----	------

30. 1. C; 2. A; 3. E; 4. B; 5. D;

Për një përgjigje të saktë një pikë; për dy përgjigje të sakta dy pikë, për tri përgjigje të sakta tri pikë; për katër ose pesë përgjigje të sakta katër pikë.

31. 1-B; 2-A; 3-D; 4-C

Për një përgjigje të saktë 1 pikë ,për dy përgjigje të sakta 2 pikë, për tri përgjigje të sakta 3 pikë.

32. A) koha e gurit - 1 pikë

B) koha e hekurit - 1 pikë

33. A) jonian - 1 pikë

B) korinthus – 1 pikë

34. A) patricët – 1 pikë

B) plebejëët– 1 pikë

Renditja nuk është me rëndësi.

35. A) Rënia e Perandorisë Romake Perëndimore 1 pikë
B) Kalimi i Muhamedit nga Meka në Medinë (fillimi i islamit) 1 pikë
C) Ndarja e Kishës së Krishterë (Katolike) 1 pikë
D) Mihaillo kurorëzohet për mbret ose Zeta u bë mbretëri 1 pikë

36. A) Stefan Nemanja 1 pikë
B) Stefan Prvovjençani 1 pikë
C) Uroshi I 1 pikë

37. A. I Evropës Perëndimore 1 pikë
B. I Evropës Lindore 1 pikë
C. Islamo-arab 1 pikë

38. A) Mbretëria e Habsburgëve (Austria) 1 pikë
B) Mbretëria Osmane (Turqia) 1 pikë
C) Republika e Venedikut (Venecia) 1 pikë

Renditja nuk është me rëndësi.

39. A) Jakobinët 1 pikë
B) Zhirodinët 1 pikë

Renditja nuk është me rëndësi.

40. Pozita e vështirë e popullatës serbe në pashallëkun e Beogradit, - 1 pikë

Shkaku i masakrimit të princërve - 1 pikë

41. A) Senatin 1 pikë

B) Gardën 1 pikë

C) Perjanikët (rojtaret e gardës) 1 pikë

42. A) Piemonti - 1 pikë

B) Prusia - 1 pikë

43. A) te Jitllandi 1 pikë

B) Britania e Madhe (Anglia) dhe Gjermania 1 pikë

44. Përgjigjja e mundshme: Lituania, Letonia, Estonia, Finlanda, Poloni, Çekosllovakia, Austria, Hungaria, Mbretëria SKS/ Jugosllavia

45. A) Këshilli jugosllav 1 pikë

B) qeveria serbe 1 pikë

Renditja nuk është me rëndësi.

46. A) demokracia qytetare 1 pikë

B) socializmi 1 pikë

C) fashizmi 1 pikë

47. A) rajonet e Zetës

B) banovinat e Zetës

48. A) Lufta antifashiste 1 pikë

B) Lufta qytetare 1 pikë

C) Revolucioni socialist 1 pikë

Renditja nuk është me rëndësi.

Literatura:

- Millada Kasumović, Goran Marković -Historia për klasën VI , Podgoricë 2006
- Radovan Popović, Dragan Miranović- Historia për klasën VII, Podgoricë 2007
- Zhivko Andrijašević, Sait Šabotić, Dragutin Papović, Slobodan Drobnjak- Historia për klasën VIII, Podgoricë, 2008
- Sllavko Burzanović, Jasmina Gjorgjević- Historia për klasën IX, Podgoricë 2009